



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:262368

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05693370

C.nr. 578/22

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, me bashkëpunëtore Albulena Morina-Lulaj, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit: Z.P, nga fshati , Komuna Klinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson i autorizuari Av.Fisnik Mujaj, avokat në Pejë, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja Ritë Konjuhi, me bazë juridike: kompensim Dëmi, vlera e kontestit: 1000 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 15.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET e tërhequr padia e datës 09.12.2022, e paditësit Z P, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, me bazë juridike: kompensim dëmi, vlera e kontestit: 1000 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Në këtë gjykatë, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar padi me datë 09.12.2022, kundër të paditurës: Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, me bazë juridike: kompensim dëmi, vlera e kontestit: 1000 euro.

I autorizuari i paditësit pas seancës përgatitore e mbajtur me datë 18.12.2023, me parashtrësën e datës 15.04..2024, e ka njoftuar gjykatën që e tërheq padinë në raport me të paditurën, pasi që me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore dhe nuk ka interes juridik që të vazhdoj kjo procedurë juridiko kontestimore.

Sipas nenit 261 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. . Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 lidhur me nenin 387 par. 1 pika c dhe neni 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

C.nr.578/22, datë 15.05.2024

Gj y q t a r j a:
Fllanza Hashani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.